

Raporti i 1 Qershorit 2011

Miredita ! Te gjithë Ju te nderuar pjesemarrës!

Une jam Egi dhe ju pershendes ne emer te grupeve te udhehequra nga femijet “ Zeri 16 +” Elbasan, Peshkopi e Durres, te Qendrave Rinore Kucove e Cerrik si dhe te Qeverise se Nxenesve nga shkollat e Gjirokastrës.

Ne te gjithë mbeshetemi nga organizata “Save the children” te cilen gjejmë rastin ta falenderojmë e t’i urojme suksese ne veprimtarine saj lidhur me te drejtat e femijeve .

Me lejoni qe se pari te uroj te gjithë femijet e Shqiperise Gezuar festen e 1 Qershorit!

Sic e vini re zeri yne ne konference po vjen cdo vit e me i forte. Prej disa vitesh ne kemi qene krah jush per te ndihmuar, por dhe monitoruar respektimin e te drejtave te femijeve ne rajonet nga ne vijme.

Ne deshrojme te falenderojmë sot dhe t’u jemi mirenjohes te gjithëve ju qe na keni ndihmuar dhe mbeshetur ne permbushjen e te drejtave tona . Ne bashkepunim me ju ne kemi arritur te ndikojmë ne permiresimin e situates se femijeve ne rajonet tona.

Keshtu, midis te tjerave po permendim, ne Elbasan, Peshkopi e Durres ne femijet jemi tashme pjese e konsultimeve per vendimmarrje me keshillin e bashkise dhe kryetarin e bashkise ne ceshtjet qe kane te bejne me femijet, jemi pjese e tryezave teknike e atyre antitrafik te femijeve. Ne keto rajone ne kemi nje bashkepunim shume te mire me organizatat jofitimpruresë qe mbeshetesin te drejtat e femijeve. Ne kemi rritur ndjeshem pjesemarrjen e femijeve ne nevoje ne aktivitetet e tona.

Ne kemi organizuar vazhdimisht fushata lobuese e advokuese per mbrojtjen e femijeve . Nje sukses i madh i femijeve te Elbasanit eshte fakti i perfshirjes si konsulente per hartimin e planit social te zones .

Ne Peshkopi eshte rritur numri i te rinjve qe vazhdojne shkollen e mesme dhe femijet nuk kryejne me dezurnin ne shkolla. Eshte rritur me 10% fondi i bashkise per shkollat.

Femijet e Durresit kane realizuar nje publikim per te drejtat dhe detyrat, kane forcuar bashkepunimin me DAR dhe me Bashkine ne zbatimin e aktivitetëve dhe kane rritur pjesemarrjen e femijeve te zonave periferike ne aktivitetet;

Te rinjte ne Kucove kane arritur te sigurojne nje pjese te buxhetit nga Bashkia, per aktivitetet qe kryejne ne qender. Ata ndjehen te perfaqesuar ne Bashki dhe bashkepunojne fort me institucionet, vecanerisht me policine. Ata kane kryer nje sere trajnimesh nga te rinjte per te rinjte, kane kryer mjaft aktivitetet ne komunitet te cilat kane synuar dhe kane sjelle ndryshime ne edukimin e komunitetit si dhe kane nje partneritet shume te mire me Njesine per Mbrojtjen e Femijeve.

Te rinjte ne Cerrik kane kryer nje sere veprimtarish per ndergjegjesimin e te rinjve per ceshtje te ndryshme si besueshmeria e QR, aktivitetet ne komunitet ; ndergjegjesimi dhe trajnimet me prinder.

Femijet e qeverise se nxenesve ne Gjirokastrë kane realizuar aktivitetet kunder diskriminimit duke bashkepunuar me aktoret lokale dhe vazhdimisht ngrene zerin per perfshirjen me te gjere te komuniteteve te tjera te femijeve.

Ne jemi krenare te pohojme sot, se qe prej Janarit te ketij viti ne kemi realizuar nje studim neper rajonet tona i cili u fokusua ne dy drejtime: se pari ne dhunen dhe te gjithë format e saj qe ushtrohet ndaj femijeve ne familje, shkolle e komunitet si dhe ne nivelin e perfshirjes sociale te femijeve ne keto mjedise. gjate anketimit u zhvilluan 1168 anketime, me 835 femije dhe 333 prinder.

Pjesa me madhe e femijeve qe ne kemi anketuar raportojnë forma relativisht të lehta të ushtrimit të dhunës fizike në familje . Shifrat variojne nga 52 % ne 78%. Ndërsa per forma më të rënda nga 16 % - 36 %. Ne te njejten kohe kemi nivele relativisht te larta lidhur me ushtrimin e dhunës verbale psikologjike në familje e shprehur ne forma te ndryshme si bërtitjet , mallkimet, sharjet dhe ofendimet. Kete e pohojne nga 58 – 74 % e femijeve te anketuar. Ne nivele me te uleta por gjithesesi shqetesuese (16 – 50 %) ndeshemi me raportime mbi qëndrimet përbuzëse dhe indiferente ndaj fëmijeve. Këto forma kanë një efekt më të fortë se ato verbale, madje ndonjëherë, edhe më të madh se format e dhunës fizike, sepse e lëndojnë në dinjitet fëmijën.

Ne jemi interesuar te mesojme se cfare pasojash jane verejtur ne sjelljen e bashkemoshatareve tane pas ushtrimit te dhunes mbi ta dhe jemi ndjere keq kur kemi marre pergjigje te tilla si sjellje nervore jo normale, gjendje vetmie, mbyllje në vetvete dhe ankth deri ne 20 - 90% te tyre. Keto sigurisht paralajmërojnë për probleme të mundshme të shëndetit mendor në të ardhmen jo të largët prandaj mendojme se këtu ka vend për një kordinim më të mirë të punës së psikologut dhe stafit mësimor me fëmijët dhe familjet e tyre, pasi në masën 20 – 76 %, janë familjarët ata që shkaktojnë dhunë ndaj fëmijeve.

Ne lidhje me problemin e perfshirjes se femijeve, 61 % të deklarimeve femijet jane shprehur se ndjehen te vecuar për shkaqe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike .

Po ashtu gjate studimit tone ne kemi vene re se ka një shkallë relativisht të ulët të përfshirjes së nxënësve në diskutimin e problemeve që ka shkolla ku 68% e femijeve raportojne se nuk merret mendimi i tyre.

Numri i nxenesve qe deklarojne se nuk i drejtohen Qeverisë së Nxënësve për problemet që ata kanë varion ne rajone te ndryshme nga 39 ne 88 % gje qe flet per marrdhenien mes kesaj strukture te shkolles me komunitetin e nxenesve.

80% e femijeve te pyetur nuk kane dijeni per ekzistencën e një linje telefonike në Bashki për problemet e fëmijeve gje qe flet për difektet në punën për vendosjen dhe njohjen e saj në shkolla.

Po në këtë nivel (81%) është edhe informacioni që kanë nxënësit e anketuar lidhur me sasinë e parave që shpenzon shteti për çdo fëmije dhe i njëjtë është edhe problemi që ai shfaq.

Afërsisht i njëjti problem informimi ekziston edhe për njohjen e punonjësit të bashkisë që merret me problemet e mbrojtjes së fëmijeve. Vetëm rreth 8% e kanë njohurinë e plotë, 25% kanë dëgjuar se ka të tillë, kurse afro 68% ose nuk e dinë, ose pohojnë se nuk ka. Shifrat edhe këtu „flasin vetë”, pervec Kucoves

Sa i perket trajtimit te barabartë të nxënësve nga ana e mësuesve ne shkolla shoket tane na kane treguar se ka probleme te ketij lloji por ato jane ne nivele te ndryshme ne rajone te ndryshme. Keshtu ne Kucove ky problem eshte me i mprehte (52%) , ndersa ne Peshkopi ne nivele me te uleta (14 %) .

Keto qe kemi prezantuar me lart sigurisht qe jane vetem nje pjese e problemeve tona dhe te bashkemoshtareve tane. Duke ju siguruar se do te jemi aleatet tuaj me te mire ne do te kerkonim nga ju qe te vazhdojme te punojme se bashku per te plotesuar disa rekomandime qe e shohim te arsyeshme t'i shtrojme para jush e qe te mos mbeten ne letra por te perkthehen ne rezultate, ne jete me te mira per ne.

Rekomandime

- Ne do te kerkonim permiresimin e kushteve ne shkolla dhe pajisjen e tyre me mjete shkollore, laboratore, palestra etj.
- Deshirojme te mbeshtetet ngritja e Njesive per Mbrojtjen ne Femijeve ne Bashki dhe Komuna
- Te fuqizohen qeverite e nxenesve ne menyre qe ato te funksionojne realisht per te gjitha nxenesit
- Te sigurohet perfshirja e prinderve dhe pushtetit vendor ne aktivitete ne shkolle dhe organizata te tjera per femije dhe te rinj
- Te forcohet roli i psikologut ne shkolla
- Te vendoset dhe te funksionoj linja telefonike 24 oreshe per femijet ne Bashki e Komuna
- Te sigurohet transparenca e buxhetit per femije .
- Te mundesohet rritja e buxheteve per femije dhe te rinj ne nivel lokal
- Te instalohet sistemi i ngrohjes ne te gjitha shkollat
- Te forcohen marrdheniet shkolle – familje- komunitet permes realizimit te aktiviteteve te perbashketa
- Kurrikula shkollore te perfshije ceshtje qe kane te bejne me dhunen ndaj femijeve dhe perfshirjen sociale te tyre ne kuader te respektimit te Konventes per te Drejtat e Femijeve
- Te trajnohen mesuesit per ceshtjet e dhunes ndaj femijeve me qellim qe te mos perdoret dhuna si mjet edukimi por te zevendesohet kjo me metoda pozitive disiplinimi.
- Te sigurohet informimi i prinderve per pasojat e dhunes ndaj femijeve
- Te sigurohen kushtet per argetimin e femijeve ne shkolla e komunitet

Ju faleminderit te gjithëve dhe suksese Konferences.